



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 81, Datë 12.03.2026

MBI

MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË “RREGULLOREN PËR CILËSINË E FURNIZIMIT DHE PERFORMANCËN E SIGURISË SË RRJETIT NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 207, DATË 18.12.2017 DHE NË TREGUESIT E KRITEREVE STANDARDE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në zbatim të neneve 7 pika 1, 10 pika 2, 16, 19 gërma “h” dhe “j”, 20 gërma “a” dhe 27 pika 3 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.03.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 82/1 prot., datë 10.03.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme, Drejtoria e Çështjeve Konsumatore dhe Zgjidhjes Alternative të Ankesave dhe Drejtoria e Monitorimit të Standarteve të Cilësisë, Sigurisë së Sistemit dhe Detyrimeve të Shërbimit Publik, “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.02.2017 dhe në treguesit e kriterëve standarte të cilësisë së shërbimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 300, datë 17.11.2025, vendosi “Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017 dhe në treguesit e kriterëve standarte të cilësisë së shërbimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”.
- ERE me shkresën nr. 2865/1 prot., datë 21.11.2025, njoftoi palët e interesuara Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), Shoqatën e Mbrojtjes së Konsumatorit (MK), Agjensinë e Mbrojtjes së Konsumatorit (AMK), Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë (DHTI), Autoritetin e Konkurrencës (AK), Avokatin e Popullit (AP), Shoqatën Konsumatori në Fokus (KF), mbi vendimin nr. 300/2025 për të shprehur opinionet/komentet për ndryshimet në Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike.
- Gjithashtu, me shkresën nr. 82 prot., datë 09.01.2026, ERE njoftoi Shoqatën e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA) dhe Shoqatën Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme (AREA) mbi marrjen e vendimit nr. nr. 300, datë 17.11.2025 nga bordi i ERE-s.

- Pas përfundimit të afatit 20 ditor të marrjes së mendimeve nga palët e interesuara, rezultoi se janë paraqitur në ERE mendime nga Shoqata Shqipëtare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike me nr. 3087 prot., datë 17.12.2025 dhe 196/4 prot., datë 21.01.2026, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, si dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Në vijim, u konstatua se komentet e AAES janë përcjellë gabimisht në lidhje me rregulloren e sipërcituar, për të cilën edhe vetë Shoqata AAES ka bërë me dije në ERE.
- Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit me shkresën nr. 2865/2 prot., datë 12.12.2025 si dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 2865/4 prot., datë 24.12.2025 janë shprehur parimisht dakord brenda fushës së përgjegjësisë së tyre lidhur me vendimin nr. 307/2025 *“Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017 dhe në treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”*.
- ERE më datë 27.01.2026, organizoi seancën dëgjimore, në të cilën morën pjesë përfaqësues të OST sh.a., AAES, të shoqërisë SPV Blue 1 sh.p.k., të Avokatit të Popullit, si dhe përfaqësues të ERE-s, me qëllim diskutimin mbi komentet e palëve të interesit në lidhje me ndryshimet për të cilat ka filluar procedura me vendimin nr. 307/2025.
- Të gjithë pjesëmarrësit në këtë seancë u shprehën dakord me çdo pikë të ndryshimeve të propozuara dhe i sugjeruan ERE-s vijimin e procedurës për miratimin e këtyre ndryshimeve në rregullore, me qëllim përmirësimin e cilësisë së furnizimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.
- Treguesit e performancës AIT (Koha mesatare e ndërprerjes), ENS (Energjia e pafurnizuar) dhe SAIDI (Indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve), për të cilët ka filluar procedura me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 300, datë 17.11.2025, për efekt praktik janë rumbullakosur si vijon: nga 25.96 minuta në 26 minuta për AIT, nga 365.997 MWh në 366 MWh për ENS dhe nga 39.48 minuta në 39.5 minuta për SAIDI.
- Neni 12 i *“Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”*, parashikon se: *“Kjo rregullore është objekt rishikimi ose ndryshimi me vendim të bordit të ERE”*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në aneksin e Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të EREs nr. 207, datë 18.12.2017, miratuar me vendimin nr. 244, datë 02.12.2021, sipas tabelës së standardeve të cilësisë:
 - AIT (Koha mesatare e ndërprerjes) ishte 35 min – bëhet 26 min;
 - ENS (Energji e pafurnizuar) ishte 467 MWh - bëhet 366 MWh,;
 - SAIDI (Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve) ishte 100 min – bëhet 39.5 min;
 - VQ (Cilësia e Tensionit) ishte brenda diapazonit: -10%, +11.8 – bëhet brenda diapazonit (110 kV- 300 kV): 0.90 pu - 1.118 pu; dhe brenda diapazonit (300 kV – 400 kV): 0,90 pu – 1,05 pu.
 - Neni 6 i *“Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, shfuqizohet;

- Paragrafi i fundit i Pikës 7.1 të nenit 7 të “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, ndryshon dhe bëhet: “Nivelet e pritshme të performancës, siç miratuar nga ERE, do të vihen në zbatim menjëherë dhe do të mbeten në fuqi, deri në rivlerësimin e këtyre standardeve nga ERE në funksion të performancës së realizuar.”;
- Pika 7.2 e nenit 7 të “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, shfuqizohet;
- Pika 7.3 nenit 7 të “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, ndryshon dhe bëhet: “OST sh.a. do të propozojë për shqyrtim dhe miratim në ERE nivelin e lejuar të rishikuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në funksion të performancës së realizuar. ERE në çdo kohë, me iniciativën e saj mund të nis procesin e shqyrtimit dhe miratimit të standardeve të cilësisë së shërbimit në funksion të performancës së matur, raportuar dhe ushtruar”.
- Pika 7.4, nenit 7 të “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, ndryshon dhe bëhet: “Jo më vonë se njëherë në 3 vjet ERE do të rishqyrtojë performancën e arritur gjatë kësaj periudhe, do të rivlerësojë nivelet e pritshme të performancës dhe do të miratojë nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit.”
- Pika 9.1 e nenit 9 të “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, ndryshon dhe bëhet: “Kompensimi i klientëve fundor të lidhur në rrjetin e transmetimit, në rast të mosrespektimit të kriterëve standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje, do të bëhet bazuar në përcaktimet e Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe Marrëveshjes së Shërbimit të Transmetimit.”.

2. Drejtoria Çështjeve Konsumatore dhe Zgjidhjes Alternative të Ankesave, të njoftojë shoqërinë OST sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrît AHMETI